Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Kuvendi i Komunës Rahovec*
*Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec*

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/23 Nr. i faq/Br str/No.pg 03
Data/Datum/Date 30/01/2023


Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 03/2020 për transparencë në Komuna, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.01.2023 miraton këtë :

# VENDIM

## Për miratimin e Planit të veprimit për transparencë në Komunën e Rahovecit 2023 - 2027

1. Me këtë vendim **miratohet** Plani i veprimit për transparencë në Komunën e Rahovecit 2023 - 2027.

2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i veprimit për transparencë në Komunën e Rahovecit 2023 – 2027.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr.03/23**
**Datë: 30.01.2023**

**Defrim Kafexhiu**
**Kryesues i Kuvendit**